Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 55/17
Datë/Datum. 20.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **KRU Hidromorava sh.a.,** Gjilan	Kopje:	Paneli Shqyrtues - **OSHP Nr.55/17**
Nga:	Basri Fazliu - Ekspert shqyrtues i prokurimit Labinot Hasani – Eksperti Teknik.		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Vendosja dhe mirëmbajtja e GPS-ve në Automjete",** me nr. prokurimi: **2017/001/236.**		
Përgjigjeje në ankesë:	**OE "PBC"** SH.P.K., Prishtinë		
Datë	**20.03.2017.**		

Bazuar në nenin 113.1 të LPP-së ju njoftojmë me ekspertizën e lëndës lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Vendosja dhe mirëmbajtja e GPS-ve në Automjete",** me nr. prokurimi: **2017/001/236,** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KRU Hidromorava sh.a.,** Gjilan, dhe me përgjigjeje ndaj ankesës së operatorit ekonomik: OE **"PBC"sh.p.k**, me seli në – Prishtinë, me nr.prot.55/17, i datës **24.02.2017**

Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI
MBI EKSPERTIZËN E EKSPERTIT SHQYRTUES

		08.03.2017		**10.03.2017**		**20.03.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*data e autorizimit të ekspertizës*		*data e fillimit të ekspertizës*		*data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit:

Me datën; 24.02.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën Nr.:**55/17**, parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE)"**PBC**"SH.P.K.,Prishtinë, lidhur me aktivitetin e Prokurimit Nr.:**2017/001/236**, emërtuar: "**Vendosja dhe mirëmbajtja e GPS-ve në Automjete**", publikuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –**KRU Hidromorava sh.a.,** Gjilan, konform Nenit 113.1, të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin05/L-092, të Ligjit për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës. Ekspertët Shqyrtues/Teknik e kanë bwrw shqyrtimin e pretendimeve ankimore të parashtruar nga OE ankues.

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues: "PBC"Prishtinë:

*Pikat e dispozitave të supozuar si të shkelura në Ankesën e Operatori Ekonomik"**PBC**"SH.P.K.,Prishtinë,nga Autoriteti Kontraktues "**KRU Hidromorava sh.a.**",Gjilan, në aktivitetin e prokurimit kanë të bëjnë me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, Nenet 7, dhe 28, dhe atë;*

Neni7. Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,dhe

Neni 28. Specifikimet Teknike.

Sipas emërtimit të projekti;"**Vendosja dhe mirëmbajtja e GPS-ve në Automjete**".

<u>Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet e ankesës:</u>

Operatori Ekonomik, supozimet e tij i përshkruanduke u bazuar në procedurat e prokurimit publik sipasLigjit LPP 04/L-042, dhe atë si në vijim;

1. Konsiderojmë se AK ka shkelur **paragrafin 2 të Nenin 7**të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, sepse:

   a. Nuk ka krijuar kushte për trajtim në mënyrë tëbarabartë për OE duke ekzekutuar aspekte të aktivitetit tëprokurimit të cilat në një mënyrë reduktojnë dhe eliminojnë konkurencën mes OE, respektivisht duke diskriminuar një ose më shumë OE.

2. Konsiderojmë se AK ka shkelur **Nën-paragrafin e (iii) të paragrafit 6 të Nenin 7** të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, sepse:

   b. Ka përpiluar kritere, kërkesa dhe specifikacion teknik që eliminon e diskriminon OE, e favorizon një ose disa OE, respektivisht ka vendosur kërkesa ose kritere të përzgjedhjes, gjegjësisht;

      - kërkesa për Autorizim nga prodhuesi – MAF

      - kërkesa që OE të ketë ISO certifikatë (faqe 7) e njëjtë edhe kërkesa për ISO 27 001 certifikatë të prodhuesit (faqe 17) e që ka krijuar kushte për favorizimin ose diskriminim kundër njërit ose më shumë OE, për shkakun se asnjë procedurë e implementimit të kontratës nuk i referohet procesit të standardizuar me ISO standarde.

3. Konsiderojmë se AK ka shkelur **paragrafin2 të Nenin 7** dhe **paragrafin 2 të Nenin 28** të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, sepse:

   a. Në procedurën e prokurimit në fjalë, AK ka përpiluar specifikacion teknik që nuk sigurojnë qasje të barabartë për OE që janë të interesuar për këtë procedurë të prokurimit dhe ka ekzekutuar aspekte që favorizojnë një prodhues e diskriminojnëtë gjithë të tjerët.

   Në vazhdim po i paraqesim disa nga diskriminimet dhe favorizimet e OE të caktuara nga AK.

   Provë 1: The data center will be established in a country member state of the European Union.

   Kërkesa e AK-së, e emërtuar nga ne si "Prova 1", përbën shkelje të rëndë të Nenit 28 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, pasi që është kërkuar që hostimi i platformës të realizohet vetëm në shtetet anëtare të BE-së, me c'rast është favorizuar OE nga Kroacia "Smartivo" dhe janë diskriminuar OE rajonal dhe vendor.

   Provë 2: The system must allow access to information on the feet via native application dedicated to iOS and Android. The Mobile Application must be downloaded from Google play and App Store. For this requirement no alternatives desktop applications to be responsive on mobile devices will be acceptable.

   Kërkesa e AK-së, e emërtuar nga ne si "Prova 2", përbën shkelje të rëndë të Nenit 28 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, pasi qëkëtë kërkesë e plotëson vetëm OE Smartivo.

Për informaten tuaj, në linkun më posht mund të shihet qartë favorizimi ndaj këtij OE: http://smartivo.com/en/faq/#toggle-id-19

Provë 3: The system must be able to connect to the vehicle's CAN interface if FMS propocol is available.

Kërkesa e AK-së, e emërtuar nga ne si "Prova 3", përbën shkelje të rëndë të Nenit 28 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, pasi që kërkesën për FMS interface e plotëson vetëm OE Smartivo.

Për informaten tuaj, në linkun më posht mund të shihet qartë favorizimi ndaj këtij OE: http://smartivo.com/en/features

Nga ajo qëshihet dhe fuqishëm është theksuar më sipër, shihet qartë se ka ndodhur një mal shkeljesh ligjore përgjatë përpilimit të kritereve të përzgjedhjes dhe specifikacioneve teknike.

Për këtë arsye kërkojmë nga OSHP ta kthej lëndën në Ritenderim ose ta obligoj AK t'i Rishikoj termat e referenceës dhe të eliminoj ato që janë diskriminuese.

Dëmet materiale: Dëmet materiale për kompanin tonë sillen rreth 1000 euro, si fitim i munshëm, ndërsa për AK-në janë multi-disiplinare. Të dyja këto mund të evitohen me një lehtësi të jashtzakonshme nga AK dhe mundësohet realizim i suksesshëm i kontraës.

Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

1. Kopja e publikimit të "Njoftim për Kontratë",
2. Kopje e shkresës nga AK,
3. Kopje e vendimit nga AK,
4. Kopja e reagimit tonë në vendimin e AK-së,
5. Prova "1" e cila dëshmon OE Smartivo plotëson kërkesën teknike të parashtruar nga AK,
6. Prova "2" e cila dëshmon OE Smartivo plotëson kërkesën teknike të parashtruar nga AK, dhe
7. Prova "3" e cila dëshmon OE Smartivo plotëson kërkesën teknike të parashtruar nga AK.

Procesi i prokurimit

Data e njoftimit për kontratë në KRPP (N.42) : 14.02.2017

Lloji i procedurës së aplikuar (N.30-35):..... Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar(N.19):.....Shërbime/vlerë e vogel.

Kërkesa për rishqyrtim të vendimit nga AK (108/A):	*16.02.2017*
Afati i fundit për dorëzimin	*21.02.2017, 14:00*
Shtyrja e afatit për dorzimin e ofertave:	*21.02.2017*
Afati shtesëpër dorëzimin e ofertave:	*24.02.2017, 14:00*
Data e hapjes së ofertave:	*Nuk ka hapje*

Kriteret për vlerësim:

OFERTA E PËRGJEGJSHME ME ÇMIM MË TË ULËT.

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1) Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr 04 \ L-42. LPP i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 mund të shkarkohet nga http://krpp.rks-gov.net.
2) Dëshminë se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimit ne pron

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1)Evidenca:Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit- Aneksi 2-Origjinal.
2) Te sjellet dokumenti origjinal mbi pagesen e tatimit ne pronwe nga Komuna

III.2.2)Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesa 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
Kërkesa 2. Regjistrimi i Numrit Fiskal
Kerkesa 3.Regjistrimi ne tvsh

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Evidenca 1: Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit);
Evidenca 2: Certifikata e numrit fiskal- kopje
Evidenca 3: certifikata e nr, tvsh -kopje
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:
Kerksea 1 Operatori ekonomik duhet te ket qarkullim Bankar te pakten 18,000.00 euro tri vitet e fundit (2014-2015-2016)
Deshmia e kerkuar dokumentare

Evidenca: Te sjellet deshmi nga banka (dokument bankar mbi qarkullimin vjetore financiar)

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kerkesa 1:OE të ketë së paku një inxhinier të shkencave kompjuterike, elektronikës apo telekomunikacionit, të dëshmohet me kopje të diplomës apo certifikatës universitare.
Kerkesa 2: OE duhet të jetë i autorizuar për shitje dhe sevisimin e pajisjeve që oferton (ne ket raste paisje GPS-per Automjete)

Kerkesa:3.Operatori ekonomik duhet te ket ISO qertifikatat per veprimtari te ngjashme (sisiteme te IT-s)
Kerkesa 4.OE të ofroi dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku 2 projekte te lemës se kërkuar në tri vitet e fundit (2014, 2015, 2016)

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Evidenca:1 Te sjellet dokument , të dëshmohet me kopje të diplomës apo certifikatës universitare inxhinieri qe punon në Kompanin tuaj ofertuese (kontrate pune)

Evidenca:2 OE duhet të jetë i autorizuar, Të dëshmohet me MAF nga prodhuesi për shitjen dhe servisimin e tyre

Evidenca:3 Kopje certifikata ISO per pune te ngjashme (instalim te sisitemve IT)

Evidenca:4 Lista e Kontratave te ngjajshme me referenca ngjajshme ,minimumi dy referenca per pune te ngjashme .

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues/teknik (N. 113,114) dhe Përgjigje në pikat e ankesës:

Nga analiza dhe shqyrtimi e të gjithë dokumentacionit të bashkangjitura të aktivitetit të Prokurimit AK – **KRU Hidromorava sh.a.,** Gjilandhe i gjithë dokumentacionit të dorëzuar të tenderuesit ankues OE – **PBC**, Prishtinë, sipas procesit tëProkurimit Nr.: **2017/001/236**, emërtuar"**Vendosja dhe mirëmbajtja e GPS-ve në Automjete**", konfirmojmë që procedurat e udhëhequra kanë qenë në përputhje me Nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, pasi që nuk janë identifikuar shkelje procedurale sipas dokumentacionit të prezantuar.

Ankuesi, OE – **"PBC" sh.p.k,** me seli në Prishtinë, pretendon se AK – **KRU Hidromorava sh.a.,** Gjilan, ka bërë shkelje të paragrafit 2 të Nenit 7, nën-paragrafit (iii) i paragrafit 6 të nenit 7, paragrafi 2 neni 28, të Ligjit 04/L-042 të LPP-së, me pretendimin e shkeljeve të tyre dhe me kërkesën për rishqyrtim të procedurës tenderuese për këtë lëndë.

Duke u referuar në provat e OE ankues konstatojm:

Pretendimi ankimor nr.1

Prova 1. Eksperti shqyrtues vlerëson në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket kërkesës së FDT-së lidhur me atë se vetëm në shtetet e BE-së të bëhet hostimi i platëformës të GPS sistemit,

Eksperti shqyrtues mendon se OE ankues ka të drejtë duke atakuar shkeljen lidhur me qendren e të dhënave (hostimi) ku është kërkuar të jetë brenda shteteve të BE-së, për faktin se ky kriter i kërkuar në FDT, faqe 16, tek kërkesat në lidhje me paisjen konkretisht lokacionin e hostimit, ka bërë diskriminim territorial, kufizim të konkurences për këtë aktivitet të prokurimit në kundërshtim me neni 7 të Ligjit 04/L-042 të LPP, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Pretendimi ankimor nr.2 PROVA 2.:

Eksperti teknik vlerëson se AK-ja ka kërkuar që sistemi duhet të ofroj qasje poashtu nga aplikacionet aposistemet operative mobile iOSdhe Android. Keto aplikacione duhet patjeter doënload-uar nepermjet telefonave mobil vetem nga burimet e sigurta te App Store dhe Google Play. Per këtë kërkese asnje alternative tjeter per te doënload-uar aplikacionet mobile nga desktopet (kompjuteret) nuk lejohet.

Në këtë paragraf kërkohet që aplikacionet te ofrohen edhe per sistemet operative iOS dhe Android, dhe e vetmja mundesi e aplikacionevete GPS te jet doënload-imipermes App Store dhe Google Play. Ndersa, nuk lejohet qe aplikacioni te mund te instalohet edhe nga kompjuteret desktop. Ekzistojne edhe prodhues te tjeret të cilet ofrojne programin ne treformatet per perdorim, sipsh.

1. GPSWOX.COM Global GPS Tracking Solutions nga Britania, ofronaplikacionin per desktop, iOSdhe Android.
2. ZUBIE Business nga USA, poashtu ofron aplikacionin per desktop, iOS dhe Android.
3. Gjitheashtu, edhe GAIA GPS ofron aplikacionin per desktop, iOS dhe Android.

Konstatimi i ankuesit për shkeljen e Nenit 28 lidhur me ndërtimin e specifikacionit teknik nga ana e AK-ja dhe pretendimet ankimore që AK-ja ka favorizuar një apo më shumë kompani duke kërkuar;

- Autorizimin e prodhuesit – MAF, dhe
- ISO:27001 certifikate te prodhuesit,

Eksperti teknik konstaton që pretendimet e OE ankues nuk qëndrojnë dhe pa të drejtë ka atakuar shkeljen e Nenit 28 të Ligjit 04/L-042 të LPP, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, sepse është e drejtë e AK-së të përpiloj specifikacionin teknik në atë mënyrë që siguron zhvillimin dhe përfundimin të suksesshëm të projektit pasi që kemi të bëjmë më shërbim profesional, në rastin konkret autorizimi nga prodhuesi dhe certifikata ISO, janë kërkesa për shërbim profesional të cilat NUK diskriminojn apo favorizojnë ndonjë nga OE të interesuar për pjesëmarrje pasi që janë kritere që vlejn për të gjithë.

Pretendimi ankimor nr.3 PROVA 3:

Eksperti teknik vlerëson që kompania "Smartivo" të cilën OE ankues ju ka refereruar se AK-ja ka

favorizuar, NUK qëndron për faktin se ekzistojne dhe prodhues të tjerë të cilët prodhojn këtë llojpaisje, si psh.:

1. FALCOM Gmbh, nga Gjermani, prodhon paisjen e saj për sistemin GPS, emertuar FOX3 – CAN/FMS interface.

2. Inventure Automotive Electronics nga Hungaria, poashtu prodhon paisjen e emërtuar FMS Gateëay, e cila paisje ofron daljen e të dhënave në marrëveshje (akordancë) me standardin FMS.

3. GosafengaShtetet e Bashkuara të Amerikës, prodhon paisje ne emërtuar GosafeCAN-9600.

Shpjegim:
Qëllimii CAN bus (Controller Area Netëork bus) linjës për transferimin e tëdhënave është të përcjell parametrat për monitorim të automjeteve.
Ndërsa, FMS (Fleet Management System)ë shtë standardidizajnuar, qëpërdor FMS interfejsi (lidhjen) e cila ofron lidhje përtransferimin e të dhënave të sigurta dhe të standardizuaranë CAN bus linjën në për automjete duke përdor prizën (gjekun) e tipit J1939.Ref.: http://ëëë.gps-telematics.co.uk/documents/appnote_canbus_compatibility.pdf

Mendimi i ekspertit shqyrtues/teknik

Eksperti Shqyrtues/Teknik duke u bazuar në konstatimet e cekura në ekspertizëlidhur me aktivitetin e prokurimit: Nr.: **2017/001/236**, emërtuar **"Vendosja dhe mirëmbajtja e GPS-ve në Automjete"**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues –**KRU Hidromorava sh.a.,** Gjilan

- **Rekomandon Panelin Shqyrtues që të aprovohet pjesërisht ankesen e OE ankues "PBC"Sh.p.k. Prishtinë, lidhur me konstatimin nr.1, dhe njëherit i rekomandon panelit shqyrtues që ky aktivitet i Prokurimit i emërtuar"Vendosja dhe mirëmbajtja e GPS-ve në Automjete", me Nr. Prok. 2017/001/236, i iniciuar nga AK– KRU Hidromorava sh.a., Gjilan t'i jepet mundësi e përmisimit në përpilimin e specifikacionit teknik lidhur me konstatimin nr.1, ndërsa i njëjti aktivitet i prokurimit të vazhdoj më tutje me implementimin e projektit dhe përmbylljen e tij sipas të gjitha kërkesave të parapara me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-237, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-068 dhe i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-092 të Ligjit për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës.**